

# Hyrje

---

## ● Pse është i nevojshëm ky libër shoqërues i emisioneve radiofonike?

Ky libër do të shoqërojë Pjesën IV të kursit të gjermanishtes në radio „Deutschwarum nicht?“, ashtu si tri librat e parë. Ai do t’ju ndihmojë sa herë që do të dëshironi të përsëritni ose të thelloheni në ndonjë çështje.

Koncepti i këtij kursi të gjermanishtes kërkon që vëmendjen kryesore t’ia kushtoni dëgjimit në radio. Për këtë arsye, ju rekomandojmë të ndiqni në fillim gjithnjë mësimet në radio, gjë që do t’ju njohë me situatën ku zhvillohen ngjarjet e mësimave. Për t’ju ndihmuar, çdo emision përmban pyetje që përqëndrojnë vëmendjen gjatë dëgjimit. Këto pyetje do t’ju ndihmojnë të ndaleni në kryesoren, d.m.th të kuptoni se përse bëhet fjalë (situata, vendi, personazhet që flasin, temat e trajtuara, mjedisi etj). Përqëndrohuni në këta elementë dhe mos u përpiqni të kuptoni çdo fjalë. Ndryshe mund t’ju duket se nuk kuptoni asgjë.

Pjesa IV përmban mjaft mësim pa ushtrime dëgjimi, prandaj kushtojani vëmendjen elementëve që ju interesojnë më shumë, sipas orientimit që jepet në hyrje.

## ● Ç’është e re në Pjesën IV?

Pjesa IV përqëndrohet kryesisht në pesë zona administrative, lande (Bundesländer) të reja në Lindje të Republikës Federale të Gjermanisë. Këto janë Brandenburg (Brandenburg), Meklenburg-Parapomerania (Mecklenburg-Vorpommern), Saksonia (Sachsen), Saksoni-Anhalti (Sachsen-Anhalt) dhe Tiringeni (Thüringen). Pas ribashkimit të dy pjesëve të Gjermanisë (1990) këto zona administrative (më parë territore të RDGJ) bëjnë pjesë në RFGJ. Në mësimet e Pjesës IV do të keni mundësi të njiheni me pasurinë historike, kulturore dhe natyrore të këtyre landeve „të reja“ në Lindje të Gjermanisë.

Për t’ju dhënë një ide të përgjithshme mbi landet e reja, secilit prej tyre i kemi kushtuar nga një mësim. Mësimet e tjera rimarrin dhe zhvillojnë aspekte të veçanta - peisazhin, industrinë, artizanatin, e kulturën në RFGJ. Për t’ua lehtësuar njohjen e landeve, në mësimet do të gjeni intervista, përshkrime të ngjarjeve historike, poezi etj.

Paraqitja e plotë e landeve do të kërkonte dhënien e informacioneve më të thelluara për çdo mësim, por për shkak të vëllimit të kufizuar të kësaj metode, hoqëm dorë nga ky projekt.

Në Pjesën IV do të takoni sërish pothuaj të gjitha personazhet kryesore të kursit tonë:

- **Andreas (Andreas)**, i cili ndërkohë i ka mbaruar studimet dhe po bën një shëtitje në landet e reja në Lindje. Në mësimet e kësaj ai bën një përshkrim të shkurtër të tyre.

- Eksën (**Ex**), personazhin imagjinar, qënien femërore dhe të padukshme, por që shpesh na e tërheq vemendjen tek vetja.
- Dr. Tyrmanin (**Dr. Thürmann**), mjekun i cili ndërkohë është larguar nga klinika në Berlin dhe që tani kryesisht shkruan artikuj për homeopatinë. Ai është kthyer në qytetin e tij të lindjes, në Lajpcig.
- Zonjën Berger (**Frau Berger**), pronaren e Hotelit Evropa, e cila ka shitur hotelin. Ajo tani po kërkon të blejë një hotel të ri në landet e Lindjes, për ta filluar nga zeroja. Nganjëherë ajo e shoqëron Andrean në reportazhet e tij.
- Hana Klazen (**Hanna Clasen**), punëtoren e pastrimit të Hotelit Evropa. Tani ajo është martuar dhe nuk punon më.

Struktura e emisioneve ka mbetur e njëjtë: në fillim ju dëgjoni tekstet, pastaj shpjegimet për përmbajtjen e teksteve, shpjegimet gramatikore dhe në fund përsëritjen e teksteve. Tekstet e Pjesës IV janë natyrisht pak më të vështira. Në fillim të Pjesës IV ne do t'i riprezantojmë personazhet kryesore të kursit, në mënyrë që ju t'i ndiqni mësimet pa vështirësi, edhe sikur ta filloni kursin me Pjesën IV.

## ● Çfarë përmban ky libër shoqërimi?

### A. Informacion për çdo mësim

#### 1. Një përmbledhje të secilit mësim.

Kjo përmbledhje jep një pasqyrë të gramatikës që shtjellohet në mësimin në vazhdim. Gramatika këtu shpjegohet me hollësi, me shembuj të nxjerrë nga mësimi. Pasqyra gramatikore shpesh shoqërohet me të dhëna plotësuese për temën që trajtohet.

#### 2. Tekstet e çdo mësimi

Tekstet (reportazhe, dialogë, intervista, poezi etj) janë dhënë në gjermanisht. Për t'ju lehtësuar të fjalëvite dhe shprehjeve. Ushtrimet për të kontrolluar të kuptuarit e tekstit kërkojnë që t'i dëgjoni mësimet dhe të vendosni se cili është informacioni i saktë për të plotësuar ushtrimin. Po qe e nevojshme, ju mund të lexoni një emision në radio, ju mund ta lexoni mësimin në libër.

#### 3. Ushtrime

Ushtrimet janë, në pjesën më të madhe, ushtrime gramatikore. Por nuk mungojnë as ushtrimet për fjalorin (p.sh. në fjalëkryqet) si dhe ushtrime për përdorimin e drejtë të fjalëve dhe shprehjeve. Ushtrimet për të kontrolluar të kuptuarit e tekstit kërkojnë që t'i dëgjoni mësimet dhe të vendosni se cili është informacioni i saktë për të plotësuar ushtrimin. Po qe e nevojshme, ju mund të lexoni edhe dialogët, të cilët janë dhënë të plotë në çdo mësim.

Përgjigjet për pjesën më të madhe të ushtrimeve mund t'i gjeni në çelësin e ushtrimeve në fund të këtij libri. Çelësi i ushtrimeve përmban zgjidhje për ato ushtrime ku e saktë mund të jetë vetëm një përgjigje. Kur ushtrimet kërkojnë formulime më të lira, në çelës jepen propozime. Për rastet kur përgjigjet që duhet të jepni pritet të jenë krejtësisht të lira, në çelësin e ushtrimeve nuk do të gjeni zgjidhje.

## B Përmbledhje e gramatikës

Këtu do të gjeni përmbledhjen e çështjeve të reja të gramatikës, që përdoret gjatë mësimëve. Pikërisht gramatikore të Pjesës IV janë:

- pjesët e varura të fjalive: pyetëse të zhdrejta, pjesët e varura të fjalive kohore që nisnin me lidhëzën *wenn*, pjesët e varura me *um ... zu*, *obwohl*, *damit*, pjesët e varura të fjalive lidhore, pjesët e varura të fjalive kushtore, fjalitë që përmbajnë ndërtime me paskajore (infinitiv)
- kushtorja II e *sein* dhe *haben*, foljet gjysmëndihmëse dhe foljet me ndihmësen *würde*
- foljet pësore
- ndajfoljet përemërore (*damit*, *davon*, *darüber...*)
- krahasorja e mbimrave dhe ndërtimet me krahasore

## C Çelësi i ushtrimeve

Çelësin e ushtrimeve mund ta përdorni për të kontrolluar nëse i keni plotësuar si duhet fjalitë e mësimëve.

## D Përkthimi i dialogëve

Përkthimet janë konceptuar si një ndihmë për të kuptuar. Kjo vlen sidomos për rastin kur nuk i keni ndjekur mësimet e Pjesëve I, II, dhe III, pra nuk njihni as fjalorin dhe as gramatikën e shpjeguar në këto pjesë.

## E Fjalori alfabetik

Këtu jepen të gjitha fjalët e reja të Pjesës IV. Fjalët që kanë dalë në tri pjesët e para të metodës nuk i gjeni në këtë fjalor. Numri i mësimit, në të cilin një fjalë e caktuar del për herë të parë, jepet në kllapa pas fjalës.

Siç ndoshta e dini, ky kurs i gjermanishtes është shkruar për t'u transmetuar në shumë gjuhë të botës. Për këtë arsye, në hartimin e tij nuk ka qenë e mundur të mbahen parasysh veçoritë gjuhësore, sociale dhe kulturore të çdo vendi, pra edhe të vendit tuaj. Për këtë ju shprehim keqardhje. Por, njëkohësisht jemi të bindur se askush nuk do t'i dallojë më mirë se ju përbashkësitë dhe dallimet midis gjermanishtes dhe shqipes.\*

Uroj të keni kënaqësi dhe sukses në studimin e kursit të gjermanishtes „*Deutsch - warum nicht?*“

Herrad Meese

\* Edhe në këtë pjesë, si në pjesët e mëparshme, përkthyesi dhe përshtatësi është munduar, që sa herë ka qenë e mundur, të vërë në pah veçoritë gramatikore të shqipes përballë gjermanishtes. (Auron Dodi)